

Mvarja nga lojrat kompjuterike dhe të fatit

Brengosja se si i shfrytëzojnë fëmijët lojrat e fatit, lojrat kompjuterike dhe disa veti tjera të lidhura me këto më ka shtyr që të bëj këtë projekt ku si qëllim ka edukimin nga pasojat e lojrave të fatit dhe largimin nga ato.

Nëse do ti bëja disa pyetje sigurisht që shumica do të përgjigjen me fjalën, Po!

Keni parë se si fëmijët nën moshën madhore vizitojnë bastoret sportive?

Keni parë se si fëmijët i paguajn bastoret sportive dhe i përcjellin lojrat me një vemendje vërtet të koncentruar? (Çka do të ndodhte nëse këtë koncentrim do ta kishin në shkollë?) Keni parë se si gjeneratat e reja janë larguar shumë nga aktivitetet e lira në natyrë dhe janë mbyllur nëpër dhoma apo lokale ku luhen lojrat kompjuterike?

Nga përgjigjet e këtyre pyetjeve, vijnë edhe qëllimet e këtij projekti që synon sadopak ti zbusë dhe ti parandalon që gjenerata e ardhshme të mos bien viktimë e këtyre gjërave negative.

Me anë të kësaj broshure ne vetëm kemi parashtruar problemet aktuale të cilat ekzistojnë në shoqërinë kosovare (dhe mbarë shqiptare) ndërsa rreth punimeve tjera dhe aktiviteteve që do ti organizojmë, do sjellim broshura të veqanta. Më poshtë kemi prezantuar përmbajtjen që do të ketë kjo broshurë duke vendosur anash edhe sponsorët që e përkrahin këtë projekt.

Sponzori kryesor i projekteve në Rinia 21 është ndërmarrja Faton Media www.fatonmedia.com

- **Lojrat kompjuterike**
 - prezantimi
- **Bastoret**
 - prezantimi
- **Metodat**
 - edukative – psikologjike
 - edukative – e dhunshme
 - jo edukative – shkatërruese
- **Realizimi**
 - prezantimi
- **Analiza e projektit**
- **Burimet e materialeve**



Lojrat kompjuterike

Tëknologjia e kohëve të fundit ka shtyr që shumë fëmijë të mvaren nga lojrat kompjuterike duke u larguar me shumë nga lojrat tjera të natyrës apo sportet normale. Tëknologjia edhe pse ka përparsit e veta në shfrytëzimin për nevojat e njëzëve ne disa raste ne duhet të kujdesemi më shumë që këto gjëra ti shfrytëzojmë në mënyrë të duhur prandaj këtu do të bëj një përshkrim se si mund ti shfrytëzojmë në mënyrë të duhur edhe lojrat kompjuterike që shumë fëmijë nuk dijnë ti shfrytëzojnë ashtu si duhet dhe në fakt ata mvaren nga ato duke shkaktuar probleme tjera në jetën e tyre të përditshme.

Qëllimi im nuk është që fëmijët të ndalen ti përdorin këto lojra por mendoj se do të ishte mire që ata ti shfrytëzojnë këto lojra në mënyrë të kufizuar dhe për ti mbuluar dëshirat e tyre ata mund ti plotsojnë edhe me lojra tjera të natyrave të ndryshme që do të kenë edhe një ndikim pozitiv si psh nëse ata do të merren me sporte tjera lëvizese (futboll, vrapim etj) sigurisht do të ishte shumë me pozitive si në shëndetin e tyre ashtu edhe në shmangjen nga mvarja e lojrave kompjuterike.

E morra futbollin pasi që kjo lojë është një ndër lojrat më të popullarizuara dhe shumë të rinjë kanë filluar ti qasen më së shumti lojës në "Play Station" se sa lojës normale në fushë futbollit.

Këtu e përmenda vetëm futbollin por sigurisht ky shembull do të kopjohet edhe në lojërat tjera. Të ndalem edhe pak të lojrat kompjuterike direkt nga interneti ku edhe nga këto lojra janë shumë fëmijë janë të mvarur e sidomos lojrat me tëme luftarale si Counter - Strike etj.

Në këtë rast dua ta përmend edhe keqpërdorimin e disa gjërave tjera në internet pasi që mu me brengos fakti se në vend që të mesojn gjëra të mira nga interneti shumica prej tyre e keqpërdorin dhe këtë e bëjnë si psh duke shikuar materiale pornografike apo shumica e tyre dijn ti përdorin vetëm dhomat e bisedave, facebook, MSN dhe disa gjëra tjera ndërsa shumë gjëra që vertët janë të nevojshme për karrieren e tyre të ardhëshme ata nuk i kushtojn rëndësi.

Bastoret

Mvarja tek lojërat e fatit e sidomos bastoret sportive ka filluar të ndikoj shumë edhe tek të rinjtë e moshës nën-madhore. Në Kosovë vitëve të fundit janë hapur shumë bastore sportive dhe ekziston edhe ligji që në këto bastore personat që marrin pjesë duhet të jene të moshës madhore mirëpo në fakt këto gjëra nuk ndoshin ashtu (ndosha në disa vende respektohen por në shumë prej tyre jo, sidomos nëpër fshatra).

Siç e ceka me herët edhe pse ekziston ligji se kush ka të drejtë të luaj bastore shumë të rinje nën moshën madhore janë të mvarur nga këto gjëra. Rastin e bastorëve po e krahasoj edhe me rastin e duhanit kur ekzistojn edhe raste të tilla që prindi e dërgon fëmijën e tij që të bëj pagesën e një bastore apo shkurt ai e lejon fëmijën që të hyj në vendin ku luhen këto lojra dhe sigurisht që vetëdija e fëmijës nuk është aq e pjekur që ata ta kuptojn se për ata këto lojra nuk duhet lejuar që të luhen.

Një veti negative këtu mund të vrehet kur fëmijët i shfrytzojnë edhe parat e fundit që prinderit e tyre ju japin për të blerë diçka për të ngrënë në shkollë kurse ata në fshetësi i kursejn këto dhe luajn bastore apo siç e përmenda me herët luajn ndonjë lojë kompjuterike ndërsa në anën tjetër edhe pse dëshirojnë që të blejnë diçka për të ngrënë ata u kursejn këto para për lojra sepse kanë filluar të mvaren nga këto.

Ekzistojn shumë raste të dhimbëshme kur edhe fëmijët presin me orë të tëra në televizione apo internet ti shikojn rezultatët e lojrave sportive se si po shkojnë dhe këtu përveq vetive negative që i përmenda më herët lindin edhe vetit tjera negative ku interesimi për arsim bjerë në një nivel më të ulët.

Athu sytë e mi kanë parë gjëra të turbullta në këto raste apo edhe ju keni parë dhe e dini se ekzistojn por ka shumë pakë që kujdesën për gjëra të tilla që në realitet ndikojn shumë negativisht për të ardhmën e fëmijëve por vallë sa kujdesemi ne!!!?

Realizimi

Ekzistojn metoda të ndryshme në realizimin e këtij projekti dhe çdonjëra prej tyre ka edhe efektin e vetë. Po i përmend vetëm disa prej metodave realizuese të cilat shpresoj ti realizoj në të ardhmën:

1. Botimi i disa broshurave rreth mvarjes nga lojrat kompjuterike dhe vetive negative të tij.
2. Botimi i disa broshurave rreth mvarjes nga bastoret dhe vetive negative të tij.
3. Krijimin e një bashkëpunimi ndërmjet fëmijëve dhe prindërve
4. Ligjerata dhe kontakte direkte me fëmijët
5. Aktivitete të lira sportive që simbolizojn vetit pozitive nga largimi i lojrave kompjuterike dhe të fatit.
6. Aktivitete të ndryshme në qendra rionre etj.

Të gjitha këto janë vetëm si plan të cilat mund të realizohen me krijimin e grupeve të ndryshme.

Analiza e projektit

Suksesi i projektit sigurisht do të mvaret edhe nga analizat, kritikata, vërejtjet dhe sugjerimet tjera të cilat do të bëhen kohë pas kohe gjatë rrjedhës së projektit. Ne i mirëpresim të gjithë bashkëpunorët që ti shprehim mendimet e tyre rreth idesë, qëllimit dhe çështjeve tjera që i përkasin projektit.

Te analizat e projektit do të hyjn edhe raportet 3 mujore të cilat do ti sjellim pas një pune të përbashkët me nxënësit dhe arsimtarët. Përveq analizave tona ne do ti marrim edhe mendimet e ekspertëve tjerë që mirrem me çështjet e arsimit. Duke shpresuar se projekti ynë do të ketë një sukses në mbarë Kosovën le të presim për raportet e para të cilat do ti prezantojm tek webfaqja zyrtare www.rinia21.com

Burimet e materialeve

Ideja dhe të gjitha materialet e këtij projekti janë realizuar nga

Faton Krasniqi
www.fatonkrasniqi.com